



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 875/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Arta Elshani, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.875/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga Arta Elshani, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021, nga Arta Elshani, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog, me të cilën pretendon se në VV 0622C/03D dhe 0622C/01R ,gjatë procesit të numërimit të votave janë bërë lëshime teknike, sepse sipas familjarëve të saj e kanë votuar më shumë votues.

Parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë, si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për pasqyrim jo të drejtë të rezultateve edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave familjarëve të saj, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i Arta Elshani, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik AAK, dega në Istog, nuk është bazuar në asnjë dëshmi bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit apo regjistrimit të votave të kandidates në fjalë, dhe si i tillë apeli vlerësohet si i pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli parashtruar nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësra

Anr.875/2021 më datën 07.11.2021



Kryesues i Panelit
Zynda Haziri

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.